

Sigurimi i Jetës për Kreditë Konsumatore të Pasiguruara

Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, kalon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.

Sigurimi i Jetës së debitorit ofron mbulim në rast të:

- Humbjes së Jetës së personit të siguruar kredimarrës për shkaqe natyrore apo aksidentale;
- Paaftësisë së plotë e të përhershme si rrjedhojë nga aksidenti.

Në këto raste shoqëria e sigurimit do ti paguajë bankës, për llogari të kredimarrësit, shumën e mbetur të principalit për kredinë e përcaktuar në policë pranë Bankës së Tiranës në kohën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Karakteristikat e sigurimit të jetës për kreditë konsumatore te pasiguruara :

Ky Sigurim është një garanci financiare si për bankën ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.

I siguruari është kredimarrësi i cili ka marrë kredi konsumatore të pasiguar pranë Bankës së Tiranës, me moshë nga 18 deri në 65 vjeç (pavarësisht afatit të kredisë, në çdo rast kontrata e sigurimit përfundon në ditën e datëlindjes së 68-të të personit të siguruar).

Shuma e sigurimit është shuma e kredisë maksimumi deri në EUR 17,000.

Primi i sigurimit përlllogaritet 1.2% e shumës së kredisë dhe paguhet në fillim te kredisë për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë.

Kohëzgjatja e policës së sigurimit është për të gjithë periudhën e kredisë me afat maksimal deri në 10 vite.

Përfitimi i pagueshëm është shuma e mbetur e kredisë në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, sipas tabelës së amortizimit të kredisë dhe paguhet në vlerë monetare nga Kompania e Sigurimit në rast vërtetimi të ngjarjes së siguruar.

Individët që nuk sigurohen:

- Individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoja, sindroma organiko-cerebrale;
- Individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm;
- Individë mbi 65 vjeç dhe më të rinj se 18 vjeç.

Njoftimi i ngjarjes duhet të kryhet me shkrim drejt shoqërisë së sigurimit nga brokeri brënda 30 ditëve nga data që merret dijeni nga pasjetuesit për ngjarjen.

Kushtet e përgjithshme të sigurimit duhen disponuar, kuptuar dhe pranuar nga i Siguruari.